

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“JONN” shpk

KREU I
Forma ligjore, emërtimi, selia e shoqërisë.

Neni 1
Forma juridik

Tirane datë 30/12/2024

Në mbështetje të vullnetit të Ortakëve të shoqërisë, si dhe në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare”, i ndryshuar, neni 68 i Ligjit 9723 datë 03.05.2007, “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, Shoqëria Tregëtare “JONN” Sh.p.k. formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e cila do të funksionojë sipas dispozitave të (këtij statusi) dhe aktit të saj të themelimit.

Kjo shoqëri krijohet nga ortakët:

Niko Konomi, i biri i Odhisesë dhe i Kaliopit, i datëlindjes 20.03.1956, lindur në Dhërmi dhe banues në Vlorë, me adresë: Njësia Administrative Zgijë 1.L “15 Tetori, Nd.0, H.0, Ap. 0, Vlore 9401, i datëlindjes 20.03.1956, me nr. personal F60320247K.

Rovena Nikolla, e bija e Bashkimit dhe e Adjana, e datëlindjes 19.01.1990, lindur në Berat dhe banuese në Tiranë, me adresë: me nr.personal J05119109L.

Ortakët e lartpërmendur vendosin bashkërisht krijimin e shoqërisë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar “JONN” sh.p.k.

Neni 2
Kohëzgjatja



Kohëzgjatja e shoqërisë është e pacaktuar. Kjo shoqëri mund të përcaktojë, zgjasi ose të zvogëlojë afatin me Vendim të Asamblesë të Jashtzakonshme të ortakëve një ose disa herë,

Neni 3
Selia

Shoqëria ka selinë ligjore në Tiranë, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta” pranë ish Ekspozitës Shqipëria Sot Tiranë.

(1) Adresa e faqes së Internetit të Shoqërisë është:

(2) Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon:



Veprimtaria e shoqërisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët dhe agjencitë e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë dhe Administratorit.

Shoqëria mund të krijojë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato krijohen dhe prishen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

KREU II

OBJEKTI, KAPITALI FILLESTAR DHE KUOTAT


Neni 4

OBJEKTI

Objekt veprimtarie të Shoqërisë:

Shoqëria ka si objekt veprimtarie të saj aktivitetet që paraqiten në vijim:

- Grumbullimi, prodhimi dhe përpunimi i artikujve bujqësore e blektoral, ushqimore, i nënprodukteve të gatshme e gjysëm të gatshme:
- Ngritja dhe shfrytëzimi i linjave të industrisë ushqimore për përpunimin e frutave, të perimeve, të peshkut dhe të mishit:
- Prodhimi dhe tregëtimi me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të pijeve alkoolike dhe jo alkoolike:
- Import- eksporti i lëndëve të para, i mallrave industrial, ushqimore, dhe i mallrave të natyrave të tjera, i makinerive dhe i materialeve e pajisjeve ndihmëse për montimin dhe mirëmbajtjen e tyre:
- Ndërtimi i objekteve të banimit, objekteve industriale, i objekteve bujqësore dhe veprave të artit me karakter bujqësor, i rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësave dhe shkarkuesve:
- Prodhim dhe tregëtim me shumicë e pakicë i të gjitha llojeve të materialeve të ndërtimit:
- Projektme në fushën e ndërtimeve për të gjitha llojet e tyre dhe për të gjitha kategoritë e punimeve brenda vendit:
- Investime dhe sipërmarrje për instalimin e sistemeve të ngrohjes dhe të freskimit të objekteve gjatë procesit të ndërtimit ose në procesin e rikonstruksionit të tyre:
- Aktivitet në zbulimin e burimeve minerare dhe në shfrytëzimin e tyre për të gjitha kategoritë e mineraleve:
- Veprimtari në fushën imobilare si shitje, blerje dhe dhënie me qera të pronave dhe pasurive të paluajtëshme;
- Aktivitete prodhimi, shërbimi dhe përpunimi në dru, mobileri, në metal, plastikë, në xhama, në qeramikë, në gur, në cemento, në kulturat bujqësore, në kultivimin e luleve natyrale, në pyje dhe në akuakulturë:
- Ngritje dhe shfrytëzim bare, restorante dhe hotele:



- Ngritje dhe përdorim agjensish turistike, exchange dhe publicitare:
- Shërbime të ndryshme ndaj publikut me rrobaqepsi, parukeri, transport brenda e jashtë vendit:
- Tregëti me shumicë e me pakicë i karburanteve të llojeve të ndryshme, i vajrave lubrifikantë dhe i nënprodukteve të tjera të naftës.
- Te gjitha veprimtaritë e mësipërme do të realizohen në të drejtën e importit dhe eksportit komform kërkesave specifike të legjislacionit Shqiptar për seicilen veprimtari.
- Veprimtari për projektim dhe ndërtime e rikonstruksione të veprave industrial e sociale, banesash shumë katëshe dhe vilash, veprash urbane, rrugë e kanalizime, shërbime publike për panaire e ekspozita, Import-eksport dhe tregëti me shumicë e pakicë I materialeve të lëndëve të para për ndërtim, të gjitha llojet e inerteve që prodhohen prej guri, cdo material apo lëndë e parë që përdoret në ndërtime, akuakultura në fushën e riciklimit të gomave, në fushën energjitike etj. Shërbim internet, ndërtim rrjetesh ujesjellësa të furnizimit me ujë, ndërtim impiantesh të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij, pastrimit të ujërave detare, liqenor dhe lumor. Ndërtim rrjetesh gazsjellsa. Punime topogjeodezike, mjedisi, nëntoksore, ura e vepra arti, veshje fasadash, rifiniturë muraturë, druri, material plastike, xhami, punime për prishjen e ndërtimeve.
- Ndërtim digash, vepra kullimi dhe vaditje, ndërtime detare dhe thellimi në ujë. Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime.
- Ndërtime N/stacionesh, kabanat e transformatorëve, shtrim linjat tensionit të lartë, të mesëm dhe të ulët të shpërndarjes së energjisë, ndërtim impiantesh për prodhim energjie elektrike. Punime strukturore special, punime mbi shina, traversa, impiante ngritës dhe transportues. Ndërtim barrierra dhe mbrojtje rrugore, sinjalistika rrugore, sinjalistik ndricuese. Shtrim të linjave telefonike dhe telekomunikacioni. Ndërtimi I impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane. Shpime gjeologo- inxhinierike, puse e shpime për ujë. Instalime të impianteve të telefonisë, kondicionimit. Testime dhe kolaudime me laborator për pajisje elektrike, transformator etj. Transport lëndë diegëse (nafte) për nevoja të shoqërisë. Kultivim I fruta - perimeve, prodhime bujqësore bio. Përpunim I fruta -perimeve teknologji e përpunimit dhe konservimit të fruta-perimeve. Agroturizëm dhe ambiente akomodimi tradicionale, bletari, përpunimi dhe tregëtimi I mjaltit, përdorimi I teknologjive me energjitë rinovueshme për ngrohjen, kultivimi I fruta perimeve në ambiente të mbrojtura, serra. Aktiviteti nënujor zhytje. Organizim udhëtimesh turistike, kulturore, individuale ose në grupe për shtetas shqiptar dhe të huaj, brenda dhe jashtë vendit.
- Transport detar me mjete lundrimi të grupeve turistike, agjensitë turistike, etj.
- Promovimi dhe veprimtari në fushën e turizmit, hoteleri, bar-restorant etj.
- Grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve jo të rrezikshme. Tregëtim I mjeteve të rënda për punime civile dhe impianteve industrial të ndryshme. Atelier, stilime, riparime, shitje me pakicë veshjesh dhe të aksesoreve të ndryshëm. Shfrytëzim i mineraleve dhe inerte guri të grupeve I, II, III, IV. Prodhim inerte lloji i mineralit gur gëlqeror etj. Shitje të materialeve gur, inerte si dhe nënprodukteve të tjera. Transport gurësh, materiale inerte dhe gëlqerore me mjetet e veta ose me qera. Gërmime dheu dhe celje rrugësh për kalim mjetesh.
- Tregëtimin e mjeteve të rënda dhe të mjeteve të tjera të cdo lloji.
- Tregëtimin e artikujve të ndryshëm industrial, bujqësore e blektoriale.

- Tregëtim pajisjesh elektro shtëpiake, elektronike dhe kompjuterike higjeno sanitare dhe hidraulike si dhe prodhime qiramike artizanati etj.
- Administrim dhe drejtim transporti.
- Spedicionier mallarsh dhe furnizim anijesh.
- Transport udhëtarësh dhe mallrash të ndryshme brenda dhe jashtë vendit.
- Tregëti me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektrike.
- Investime në fushën e ndërtimit. Punime dheu me punime eventuale murature e beton arme, prishje dhe punime në tokë të gërmuar, prodhim materiale inerte gurë, prodhim elemente betoni e betonarme të zakonshëm, parandëruar, gurë dekorative.
- Ndërtime civile dhe ekonomike, ndërtime objektësh, ndërtime rrugësh, ndërtim ura dhe vepra arti, ndërtime portuale, bankina, basene, pontile, ndërtime ujësjellësa, kanalizime, kanale dhe impiante vaditje, ndërtim diga, vepra të karpentjerie, instalimi I impianteve, higjenike, guzhina, lavanteri, hidrosanitare, mirmbajtja e tyre, instalimi I materialeve prej druri , metalike, plastike, xhami,etj; punime bojatisje, hidroizolimi, termoizolimi, akustike, kundër zjarrit; pastrami I sipërfaqeve urbane, kryerja e punimeve në shërbesa funerale, punime të sinjalizimit rrugore horizontal dhe vertical.
- Import- eksport- tregëti me shumicë dhe pakicë të peshkut dhe mallrave industrial blektoriale dhe bimëve medicinale, të artikujve farmaceutike, konfeksione si dhe tregëtimin e tyre me shumicë dhe pakicë.
- Import -Eksport për materiale ndërtimi, prodhime elektromjekësore. Për paisje shkollore dhe spitalore. Për të gjitha prodhimet hidraulike dhe hidrosanitare.
- Import -Eksport të alkooleve si dhe cdo veprimtari tjetër tregëtare që të jetë e ligjshme dhe e dobishme për veprimtarinë e shoqërisë.
- Veprimtari në fushën e restaurimit te objekteve të vecanta kulturore ose të kultit, veprimtari imobilare për shitje dhe blerje.
- Dhënie të Konsulencës, shërbime të Marketingut dhe të Promocionit në fushën e Tregëtisë si dhe realizimi I kontakteve të shoqërive vendase me shoqëri të huaja, ndërmjetësimi për lidhjen e kontratave, përfaqësimi I ndërsjelltë për shoqëritë vendase dhe të huaja.
- Më në përgjithësi shoqëria do të kryejë cdo aktivitet të nevojshëm apo të dobishëm për përmbushjen e qëllimeve të shoqërisë.

Neni 5

KAPITALI THEMELTAR


Kapitali themeltar I kësaj shoqërie përbëhet në të holla me një vlerë prej 100.000 (njëqindmijë) lek, me 100 pjesë, me vlerë nominale 1000 (njëmijë) lek seicila pjesë dhe është krejtësisht I derdhur në të holla.

Ky kapital themeltar zotërohet nga dy ortakët në këtë mënyrë:

Z. Niko Konomi zotërues i 1 kuote që përfaqëson 50% të kuotave.

Zj. Rovena Nikolla zotëruese e 1 kuote që përfaqëson 50% të kuotave.

Kapitali themeltar ose pjesë të caktuar të tij janë të transferueshme si ndërmjet ortakëve ashtu edhe përkundrejt personave të tretë. Transferimi i kapitalit ose i pjesëve të tij ndërmjet ortakëve ose në favor të një personi të tretë bëhet gjithmonë me miratimin unanimit të tre ortakëve dhe me akt notarial.




Nëqoftë se njëri nga ortakët dëshiron të shesë pjesën e kapitalit të tij në natyrë duhet të respektojë të drejtën e parablerjes nga ortaku tjetër.
Të gjitha veprimet e shoqërisë mbi kapitalin fillestar bëhen me miratimin e dy ortakëve.
Vlerësimi i kapitalit themeltar në natyrë bëhet nga ortakët në një marrveshje të vecantë ose nga një ekspert kompetent i caktuar nga ortak të kësaj shoqërie.

NENI 6 ADMINISTRIMI

Shoqëria do të ketë administrator të saj Z.Niko Konomi. Administratori zgjidhet për një afat kohor deri në 5 (pesë) vjet , duke filluar ky afat sot nga data 30/12/2024 – 29/12/2029
Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ua jep shprehimisht ortakëve.

NENI 7 REGJISTRIMET

Fillimin e aktivitetit të saj tregëtar kjo shoqëri e lidh me regjistrimin e saj në Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit.
Përsa nuk është folur shprehimisht në aktin e themelimit do të pasqyrohet hollësisht në dispozitat e statutit.

Selia e Shoqërisë do të jetë në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta” pranë Ish Ekspozitës “Shqipëria Sot” Tirane.

Adresa e faqes së Internetit të Shoqërisë është:

Adresa e Shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: jonshoqeria @gmail.com

Veprimtaria e shoqërisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet nga degët dhe agjencitë e saj, të cilat funksionojnë në rrethe apo ndarje të tjera administrative të Republikës së Shqipërisë nën drejtimin e Drejtorisë dhe Administratorit.

Shoqëria mund të krijojë degë, agjenci dhe zyra përfaqësimi të reja jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë. Ato krijohen dhe prishen me vendim të Asamblesë së Ortakëve.



**ORTAKËT THEMELUES
NIKO KONOMI
ROVENA NIKOLLA**

